

Kompensimi i ish-pronarëve, Toro: Procesi shkon 700 vjet

» [Dërguar më: 07/08/2011 - 15:52](#)

Lajme te ngjashme

Tani që Itaka shkon drejt Uliksit të saj

• Datë: May 22, 2011

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës "Pronësi me Drejtësi", Agim Toro, në një intervistë të dhënë dje për "Gazeta Shqiptare" ka deklaruar se plani i veprimit për çështjet e pronave i miratuar pak muaj më parë nga qeveria, do të jetë sipas tij, dështim dhe nuk do të sjellë asnjë përmirësim të problematikës. Sipas Toros, me ritmet e 6 viteve të fundit të kompensimit të ish-pronarëve, procesi pritët të shkojë 600-700 vjet.

Z.Toro, si e komentoni të ashtuquajturin "Plan masash" të miratuar pak muaj më parë nga qeveria për zgjidhjen njëherë e mirë të çështjes së pronave?

Ne jemi kundër këtij të ashtuquajtur "Plani masash", që u miratua nga qeveria në fundin e muajit maj, dhe që tashmë është botuar edhe në Fletoren Zyrtare, sepse në gjykimin tonë kemi të bëjmë me një plan masash të dështuar dhe që nuk ka për të sjellë asnjë përmirësim të problematikës. Në këtë dokument ka një sërë masash që qeveria i ka vënë vetës. Ne jemi kundër, sepse plani i masave nuk është vetëm për 1 ose 2 vjet, por për 18 vjet. Kjo është absurde, sepse qeveria aktuale nuk ka fuqi për të përcaktuar detyrat për një qeveri që do vijë pas të paktën dy legjislaturash. Është absurde së dyti, sepse ky "plan masash" duhet të kthehet në ligj, pra ta miratojë parlamenti. **Ligjshmëria ka qenë e pasaktë dhe nuk është zgjidhur problemi, megjithëse gjatë këtyre viteve qeveria ka pretenduar se çështja e pronave është prioritet.**

Qeveria ka pranuar së fundimi se do bëjë ndryshime në ligj, në shtator apo tetor të këtij viti, sepse ky ligj nuk mundet dot të zgjidhë problemin e madh të pronave. Për ta përmbledhur ky plan masash duhet të ishte transparent e të hartohej në prani dhe të palëve të treta, ndërsa është për të ardhur keq që ky plan masash u hartua nga qeveria, ndërsa duhet të hartohej nga parlamenti shqiptar.

Komisioni Evropian i ka sugjeruar shpeshherë qeverisë shqiptare të kthejë vëmendjen ndaj procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, pasi ai është primar në negociatat për integrimin drejt BE-së. Në gjykimin tuaj, qeveria shqiptare, a është vënë në lëvizje për zbatimin e

këtyre rekomandimeve?

Absolutisht jo. **Ne ende nuk kemi një faturë kompensimi.** KE i ka vënë këtë detyrë qeverisë, por kjo e fundit ende nuk po e realizon. Është kjo arsyeja pse sot në Strasburg ka mbi 500 ankesa të ish-pronarëve. Praktika e kohëve të fundit ka treguar se fatura e kompensimit të këtyre viteve të fundit për ish-pronarët ka qenë rreth 7 milionë USD. Ndërkohë që borxhi është shumë i madh rreth 30 miliardë euro. Qeveria bën vetëm demagogji sepse flet në ajër, pa shifra. **Nuk jep absolutisht asnjë zgjidhje dhe nuk merr asnjë masë për të korigjuar gabimet që janë bërë.** Dhe nëse nuk bëhen këto zgjidhje, nuk mundet të realizohet kompensimi sepse me këto ritme që është ecur nga viti 2005 e në vazhdim, procesi i kompensimit mund të shkojë 600-700 vjet.

Qeveria bën demagogji duke deklaruar se po e zgjidh çështjen e pronave, por kjo është një gënjeshtër për të thithur investitorët e huaj, të cilët kur vijnë në Shqipëri e kuptojnë më së miri se prona private në Shqipëri është ende pengesë për investimet e tyre.

A keni besim te sistemi gjyqësor në Shqipëri?

Sistemi gjyqësor në Shqipëri, të gjitha çështjet i ka zgjidhur në favor të qeverisë. Gjykata nuk e urdhëron dot qeverinë të realizojë kompensimin, në një kohë që edhe Gjykata Kushtetuese nuk i pranon fare për gjykim këto çështje. Ndërkohë kur venë pronarët në Strasburg, jo vetëm pranohen, por edhe i fitojnë gjyqet. Kjo tregon se **sistemi gjyqësor në vendin tonë është tërësisht politik dhe i shërben qeverisë së radhës në pushtet dhe jo ish-pronarëve.**